



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. 48/2014

**PËR PAGESAT E VONUARA NË DETYRIMET
KONTRAKTORE E TREGTARE¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatave ligjore për pagesat e vonuara, në rastet e furnizimit me mallra apo shërbime nga ana e ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm, duke nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve tregtare dhe, në veçanti, të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Neni 2

Fusha e zbatimit të ligjit

Ky ligj zbatohet për të gjitha pagesat e kryera si kundërpaguesë për veprimet juridike tregtare. Nuk i nënshtrohen rregullimeve të këtij ligji detyrimet apo pagesat:

- a) që janë objekt i procedurës së falimentimit të çelur kundër debitorit, përfshirë edhe procedurën me objekt ristrukturimin e borxhit;
- b) që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët;

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën 2011/7/EU, të Parlamentit Europian dhe Këshillit, të datës 16 shkurt 2011, "Për luftën kundër pagesës me vonesë në transaksionet tregtare"; Celex: 32011L000, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 48, datë 23.2.2011, f. 1–10.

- c) që lidhen me interesin apo pagesat e tjera të kryera për titujt;
- ç) që lidhen me shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, përfshirë edhe pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Veprimi juridik tregtar” është kontrata apo çdo veprim tjetër juridik, i kryer ndërmjet ndërmarrjeve tregtare ose ndërmjet ndërmarrjeve tregtare, nga njëra anë, dhe autoriteteve publike, nga ana tjetër, të cilat çojnë në lëvrimin e mallrave ose realizimin e shërbimeve kundrejt një kundërpagese.

2. “Autoritet publik” është çdo autoritet kontraktues shtetëror, si njësi e qeverisjes së përgjithshme, ku përfshihen njësitë e qeverisjes qendrore, vendore dhe të fondeve speciale.

3. “Sipërmarrje tregtare” është çdo person juridik, i krijuar sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me përjashtim të një autoriteti publik, i cili vepron në kuadër të veprimtarisë së tij të pavarur ekonomike a profesionale.

4. “Pagesë me vonesë” është pagesa që nuk kryhet brenda afatit të përcaktuar me kontratë a me ligj, nga ana e sipërmarrjes tregtare dhe e autoritetit publik, kur janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.

5. “Pagesë me vonesë e thesarit” është pagesa që nuk bëhet brenda afatit të përcaktuar me kontratë a me ligj, kur janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, por kur ka gjendje me mungesë likuiditeti në llogarinë e unifikuar të thesarit pas datës së regjistrimit në sistemin informatik financiar të qeverisë.

6. “Sistem i thesarit”, ky term ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

7. “Kamatëvonesë ligjore për pagesën me vonesë” është kamatëvonesë e parashikuar nga ligji për pagesën me vonesë, me normë interesi të barabartë me shumën e normës bazë të interesit për lekun ose normës bazë të interesit për zonën euro, apo normës bazë të interesit në monedhë të huaj dhe, të paktën, tetë pikë përqindjeje dhe që llogaritet sipas nenit 5 të këtij ligji.

8. “Marrëveshje riblerjeje (REPO)” është marrëveshja, me anë të së cilës Banka e Shqipërisë shet titujt, duke marrë përsipër t’i blejë ato sipas kushteve për të cilat është rënë dakord paraprakisht me një bankë ose degë të bankës së huaj, me qëllim zvogëlimin e përkohshëm të likuiditetit në sistemin bankar.

9. “Marrëveshje e anasjelltë riblerjeje (REPO të anasjellta)” është marrëveshja, me anën e së cilës Banka e Shqipërisë blen titujt, duke marrë përsipër t’i shesë ato sipas kushteve për të cilat është rënë dakord paraprakisht me një bankë ose degë të bankës së huaj, me qëllim rritjen e përkohshme të likuiditetit në sistemin bankar.

10. “Norma bazë e interesit për lekun” është norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjellta), miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

11. “Norma bazë e interesit për zonën euro” është norma e interesit të operacioneve kryesore të rifinancimit, të miratuara me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane.

12. “Norma bazë e interesit në monedhë të huaj” është norma e interesit të operacioneve kryesore të refinancimit, të miratuara nga organet kompetente të bankave qendrore, e cila emeton monedhën në të cilën është bërë pagesa.

13. “Shuma për t’u paguar” është principi që duhet të ishte paguar brenda afatit ligjor ose kontraktor të pagesës, duke përfshirë tatimet, taksat, tarifatat a detyrimet e zbatueshme, të përcaktuara në faturë ose në kërkesën e njëvlershme për pagesë.

14. “Urdhër ekzekutiv” është urdhri për vënien në ekzekutim të titujve të ekzekutimit, sipas nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 4

Veprimet juridike ndërmjet sipërmarrjeve tregtare dhe autoriteteve publike

Në veprimet juridike tregtare, ku debitori është një ndërmarrje tregtare apo një autoritet publik, kreditori ka të drejtë që nga dita e nesërme, pas kalimit të afatit për kryerjen e pagesës, të përfitojë kamatëvonesë, pa qenë nevoja për t’i dërguar njoftim për vendosje në vonesë debitorit, në rastet kur:

a) kreditori i ka përmbushur detyrimet sipas kontratës dhe ligjit dhe debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin;

b) kreditori nuk e ka arkëtuar shumën për t’u paguar brenda afatit, me përjashtim të rastit kur përgjegjës për vonesën nuk është debitori.

Neni 5

Llogaritja e kamatëvonesës

1. Norma bazë e interesit për lekun, e zbatueshme për llogaritjen e kamatëvonesës është:

Për gjashtëmujorin e parë të vitit, sa norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjellta), miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit të vitit paraardhës, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje, dhe për gjashtëmujorin e dytë, sipas normës së miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit përpara datës 1 korrik të vitit korrent, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje.

2. Norma bazë e interesit për monedhën euro, e zbatueshme për llogaritjen e kamatëvonesës, është:

Për gjashtëmujorin e parë të vitit, sa norma e interesit të operacioneve kryesore të refinancimit, të miratuara me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane në mbledhjen e fundit të vitit paraardhës, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje, dhe për gjashtëmujorin e dytë, sipas normës së miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane në mbledhjen e fundit përpara datës 1 korrik të vitit korrent duke i shtuar tetë pikë përqindjeje.

3. Norma bazë e interesit për monedhat e tjera, e zbatueshme për llogaritjen e kamatëvonesës, është sipas llogaritjes në lekë të normës së interesit, duke marrë si kurs të llogaritjes në lekë të detyrimit, kursin e ditës që kërkohet pagesa e kamatëvonesës ligjore.

Neni 6

Afati

Kur nga kontrata apo nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk mund të përcaktohet ndonjë afat a datë për kryerjen e pagesës, llogaritja e kamatëvonesës fillon nga data, në të cilën debitori nuk ka ekzekutuar detyrimin e tij, të kërkuar nga kreditori, sipas parashikimeve të nenit 463 të Kodit Civil. Kreditorit, të cilit debitori nuk i ka kundërshtuar furnizimin me mallra apo shërbime, i lind e drejta për të marrë kamatëvonesë, duke filluar nga dita e nesërme pas datës së afatit të pagesës, të përcaktuar në kontratë.

Në ato raste kur debitori ka refuzuar të marrë në dorëzim mallin apo kryerjen e shërbimeve, për shkak të pretendimeve që ai ka mbi to, afatet e parashikuara në këtë nen llogariten duke filluar nga data e rënies dakord ndërmjet kreditorit dhe debitorit për pranimin e mallrave, punimeve apo shërbimeve të kryera nga kreditori.

Në rastet kur afati i pagesës nuk është i përcaktuar në kontratë, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil, kreditori ka të drejtë të marrë kamatëvonesë, duke filluar nga përfundimi i afateve si më poshtë:

a) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes prej debitorit të faturës ose të një kërkesë-pagese të njëvlershme;

b) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur nuk është e qartë data e marrjes së faturës ose kërkesë-pagesës së njëvlershme;

c) kur debitori e merr faturën ose kërkesë-pagesën e njëvlershme përpara lëvrimin të mallrave ose shërbimeve, 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve;

ç) kur ligji a kontrata parashikon një procedurë të marrjes në dorëzim ose të kolaudimit, përmes së cilës vërtetohet përputhshmëria e mallrave a shërbimeve me kontratën dhe nëse debitori e merr faturën ose kërkesë-pagesën e njëvlershme përpara ose në datën kur bëhet marrja në dorëzim apo kolaudimi në fjalë, 30 ditë kalendarike pas kësaj date.

Afati i parashikuar në shkronjën “a”, të këtij neni, mund të zgjatet jo më shumë se 60 ditë kalendarike.

Afatet kontraktore për kryerjen e pagesave nuk mund të jenë më të gjata se 60 ditë nga data e parashikuar në shkronjën “a”, të këtij neni. Në ato raste kur me kontratë apo në marrëveshje me palët është caktuar një afat tjetër, ky afat konsiderohet i vlefshëm, me përjashtim të rasteve kur dëmton dhe vë në pozitë diskriminuese kreditorin.

Neni 7

Afati për autoritetet publike

Në veprimet juridike tregtare, në të cilat debitori është autoritet publik, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil dhe:

a) kur kreditori i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij, sipas ligjit dhe kontratës;

b) kur kreditori nuk është paguar, me përjashtim të rastit kur vonesa nuk ka ardhur për faj të debitorit;

c) kur nga kontrata apo nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk mund të përcaktohet ndonjë afat a datë për kryerjen e pagesës, afati i pagesës nuk duhet të jetë më i gjatë se:

i) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga ana e debitorit të faturës ose të një kërkesë-pagese të njëvlershme;

ii) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur nuk është e qartë data e marrjes së faturës ose kërkesë-pagesës së njëvlershme;

iii) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur debitori e merr faturën ose kërkesë-pagesën e njëvlershme përpara lëvrimin të mallrave ose shërbimeve;

iv) kur ligji a kontrata parashikon një procedurë të marrjes në dorëzim ose të kolaudimit, përmes së cilës vërtetohet përputhshmëria e mallrave a shërbimeve me kontratën, dhe nëse debitori e merr faturën ose kërkesë-pagesën e njëvlershme përpara ose në datën kur bëhet marrja në dorëzim apo kolaudimi në fjalë, 30 ditë kalendarike pas kësaj date.

Në ato raste kur ndërmjet kreditorit dhe debitorit ka një datë të përcaktuar për dorëzimin e faturës, afatet për pagimin e kamatëvonesave fillojnë të llogariten që nga e nesërmja e datës së përcaktuar në marrëveshje.

Afati i parashikuar në shkronjën “a”, të këtij neni, mund të zgjatet jo më shumë se 60 ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur në kontratë apo marrëveshje është rënë dakord për një afat tjetër.

Në ato raste kur autoriteti publik ka refuzuar të marrë në dorëzim mallin apo kryerjen e shërbimeve, për shkak të pretendimeve që ai ka mbi to, afatet e parashikuara në këtë nen llogariten duke filluar nga data e rënies dakord ndërmjet kreditorit dhe debitorit për pranimin e mallrave, punimeve apo shërbimeve të kryera nga kreditori.

Afati i parashikuar në paragrafin e parë, të këtij neni, i jep të drejtë kreditorit të kërkojë të marrë kamatëvonesë pas 60 ditëve kalendarike gjithsej, duke përfshirë 30 ditët kalendarike të vonesës nga thesari, në shtesë nga 30 ditët e vonesës së pagesës për shkak të autoritetit publik.

Neni 8

Zgjatja e afateve për autoritetet publike

Afatet e parashikuara në nenin 7, të këtij ligji, nuk zbatohen për sa i përket pagesave të vonuara për veprimet juridike tregtare, të kryera me autoritete publike që ofrojnë shërbime në fushën e kujdesit shëndetësor. Në këto raste afatet nuk mund të jenë më të gjata se një vit kalendarik, duke filluar nga data kur ka lindur e drejta për të kërkuar kryerjen e pagesës për shitjen e mallrave apo dhënien e shërbimeve.

Neni 9

Pagesat me këste

Për pagesat të cilat, sipas marrëveshjes së palëve, është parashikuar që të kryhen

në periudha kohore të ndryshme, nëse ndonjëri prej kësteve nuk paguhet brenda datës për të cilën është rënë dakord, kamatëvonesa dhe dëmshpërblimi i parashikuar në këtë ligj llogariten në bazë të vlerave për këstin, të cilit i ka kaluar afati i kryerjes së pagesës.

Neni 10

Afatet e marrjes në dorëzim të mallrave

Në ato raste kur, nga kontrata ose marrëveshja e palëve, është parashikuar që mallrat do të merren sipas një procedure dorëzimi apo në rastet kur duhet të bëhet kolaudimi i tyre, afati i marrjes në dorëzim apo i kolaudimit të mallrave nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë kalendarike. Ky afat fillon të llogaritet nga e nesërmja e mbërritjes së mallit në destinacionin e përcaktuar nga blerësi.

Nëse në kontratën apo marrëveshjen e palëve është përcaktuar një afat tjetër, i ndryshëm nga ai i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, ky afat do të quhet i vlefshëm, me kusht që, nisur nga natyra e mallit apo nga praktika tregtare, të mos jetë në dëm të interesave të kreditorit dhe të mos e vërë këtë të fundit në një pozitë diskriminuese.

Neni 11

Shpërblimi i shpenzimeve për rikthimin e kredisë

Kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori jo vetëm pagimin në favor të tij të kamatëvonesës për moskryerjen e pagesës në afat, por edhe pagimin e të gjitha shpenzimeve të kryera prej tij për rikthimin e kredisë, shpenzime këto të kryera për shkak të pagesës me vonesë, përveç rasteve kur debitori nuk është në faj për vonesën.

Shpenzimet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni llogariten si kosto shtesë ndaj shumës që ka lindur për shkak të pagesës së vonuar dhe përfshijnë çdo shpenzim të provuar të kreditorit, që ai ka kryer kundrejt avokatëve, shpenzime të tjera ligjore të kryera për të bërë të mundur arkëtimin e pagesës, si dhe çdo shpenzim të paguar prej tij për të vënë në ekzekutim pagimin e shumës së detyrimit.

Neni 12

Pagimi i shpenzimeve

Në rastin e pagesës së vonuar, debitori ka detyrimin për të paguar në favor të kreditorit, përveç shpenzimeve të parashikuara në nenin 11, të këtij ligji, edhe një dëmshpërblim në shumën prej 5 000 (pesë mijë) lekësh. Kjo shumë është e pagueshme menjëherë, pa qenë nevoja e kryerjes së ndonjë njoftimi nga kreditori për pagimin e saj.

Neni 13

Kushtet kontraktore

Çdo marrëveshje që përjashton palët nga detyrimi për pagimin e kamatave, në rastet e pagesës së vonuar, është e pavlefshme.

Janë të padrejta dhe nuk krijojnë efekte juridike ato kushte kontraktore në lidhje me kushtet, afatet apo norma të tjera për llogaritjen e kamatëvonesave, si dhe për mospagimin e shpenzimeve për rikthimin e kredisë, sipas përcaktimeve të nenit 11, të këtij ligji, për atë kohë sa ato sjellin një dëmtrim të shpërpjesëtuar të interesave të kreditorit dhe e vendosin këtë të fundit në një pozitë diskriminuuese.

Për konstatimin e një kushti të padrejtë, sipas paragrafit të mësipërm, i cili përkeqëson gjendjen e kreditorit, duhet të merren në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit, duke përfshirë:

- a) çdo shmangie thelbësore nga praktika e mirë tregtare, e cila bie ndesh me parimet e mirëbesimit dhe paanësisë;
- b) natyrën e mallit apo të shërbimit, me të cilin është furnizuar debitori;
- c) faktin nëse ka arsye objektive që të sjellë për pasojë shtyrjen e afateve të kontratës, sipas parashikimeve të neneve 6 dhe 7 të këtij ligji; ose
- ç) faktin nëse ka arsye objektive që të sjellë për pasojë shmangien në kryerjen e pagesës së parashikuar në nenin 12 të këtij ligji.

Neni 14

Pasojat e pavlefshmërisë së kushteve kontraktore

Në rast se një kusht kontraktor është i pavlefshëm, sipas nenit 13, të këtij ligji, kreditori ka të drejtë të kërkojë shpërblimin për dëmin e ardhur nga zbatimi i këtyre kushteve.

Nëse palët i kanë paguar njëra-tjetrës pagesa të llogaritura tej normave të përcaktuara në këtë ligj, pala e cila ka kryer pagesën, ka të drejtën e ngritjes së padisë së begatimit pa shkak, si dhe të kërimit të shpërblimit për dëmin e ardhur.

Neni 15

Detyrimet e sipërmarrjeve tregtare para hyrjes në fuqi të ligjit

Parashikimet e këtij ligji nuk do të zbatohen për detyrimet monetare që kanë të bëjnë me furnizimet e kryera për mallra dhe shërbime ndërmjet sipërmarrjeve tregtare të lindura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, por që nuk janë përmbushur ende dhe që për to nuk kanë filluar procedurat për vënien në ekzekutim të tyre.

Për detyrimet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, për të cilat ka një vendim gjyqësor, kreditori nuk ka të drejtë të kërkojë pagimin e kamatëvonesave dhe pagesave të tjera që lidhen me rikuperimin e pagesës, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 16

Titulli ekzekutiv

1. Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbartuesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur:

- a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe
- b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.

2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile.

Neni 17

Detyrimet e autoriteteve publike para hyrjes në fuqi të ligjit

Për detyrimet e autoriteteve publike kundrejt ndërmarrjeve tregtare, të lindura dhe të paekzekutuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk zbatohen parashikimet e këtij ligji. Nuk mund të kërkohet zbatimi i parashikimeve të këtij ligji në rastet e ekzekutimit të detyrimeve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nga ana e autoriteteve publike dhe të lindura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META

Miratuar në datën 24.4.2014